

INFORMACIONE LIDHUR ME BULLIZMIN NË SHKOLLA

për prindërit me gjuhë amtare të huaj

Ky udhëzues i kushtohet prindërve të fëmijëve që kanë gjuhë amtare të huaj, pra prindërve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha finlandeze, suedeze apo gjuha saame.

Në këtë udhëzues ofrohen informacione për bullizmin, ngacmimin dhe diskriminimin.

Në udhëzues poashtu tregohet se si mund të intervenohet ndaj këtyre rasteve.



etno

Etnisten suhteiden
neuvottelukunta

Etelä-Suomi

Bordi negociues
për mardhënie ndëretnike

Finlanda Jugore

Studimet tregojnë se fëmijët e emigrantëve përjetojnë më shumë bullizëm dhe dhunë fizike nëpër shkolla.

Të rinjët emigantë janë më shpesh pa shoqëri, dhe ata kërcënohen me dhunë më shpesh sesa të rinjët tjerë.

Përfitimi nga shërbimet që janë paraparë për nxënës është më i vështirë për ata sesa për të tjerët.

Të rinjët emigantë përjetojnë bullizëm jashtëzakonisht shumë.

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Häiritä on syrjintää - Ngacmimi është diskriminim 1/2018 | <https://yhdenvertaisuus.fi/policy-briefit>

Bullizmi në shkollë do të thotë,

kur ndonjë nga fëmijët bullizohet në shkollë vazhdimisht.

Bullizëm mund të jetë për shembull, kur dikush shtyen dhe godet apo shanë dhe përqesh dikë tjetër.

Bullizëm poashtu mund të jetë edhe përjashtimi nga shoqëria, biseda neveritëse apo çfarëdo qoftë tjetër, që ka për qëllim dëmtimin apo ofendimin e tjetrit.

Bullizmi ka për qëllim, që atij që bullizohet t'i ndalohet

pjesëmarrja në aktivitete të klasës, grupit apo ndonjë forumi virtual bisedues.

Në raste të shpeshta bullizmi është krim.

Për shembull, ofendimi rreth nderit, kërcënimi dhe keqtrajtimi janë vepra kriminale, të cilat shumë herë lidhen me bullizëm.

Poashtu nxitja për hakmarrje dhe bashkëveprimi me atë i cili bullizon janë vepra kriminale sipas ligjit.

Burimi: Mannerheimin lastensuojeluliitto – Lidhja e Mannerheimit për mbrojtje të fëmijëve | www.mll.fi

Ngacmim do të thotë, kur personit tjetër i bëhet një situatë e pakëndshme me ndonjë veprim apo duke i thënë gjëra të neveritshme.

Ngacmim mund të jetë për shembull, kur dikush e shan tjetrin, i përhapë thashetheme apo e ofendon në ndonjë mënyrë tjetër.

Nëse arsye e ngacmimit është ngjyra e lëkurës së tij, kombësia, feja apo ndonjë veti tjetër njerëzore, atëherë në fjalë është diskriminimi.

Burimi: Merriam-Webster (përkufizimi nga fjalorthi i fjalës “harassment”)

Diskriminim do të thotë, kur ndonjëri trajtohet më keqë sesa të tjerët bazuar në vetitë e tij personale.

Sipas ligjit askush nuk bën të diskriminohet bazuar si për shembull në arsyet në vazhdim:

- mosha
- origjina
- shtetësia
- gjyha
- feja
- bindja
- orientimi seksual
- arsye tjetër personale

Burimi: Yhdenvertaisuusvaltuutettu - Ombudspersoni për mosdiskriminim | www.syrjinta.fi

Çdo shkollë ka për obligim të bëjë **planin për mosdiskriminim**.

Sipas ligjit për mosdiskriminim (paragrafi i 6§) shkolla duhet të vlerësoj se si të veprohet në mënyrë që askush në shkollë të mos bullizohet, diskriminohet apo të ngacmohet.

Shkolla duhet të merr masa të duhura, nëse në shkollë nuk realizohet mosdiskriminimi.

Burimi: Opetushallitus – Agjencia kombëtare e arsimit | www.oph.fi

Si mundesh të intervenosh ndaj bullizmit?

Mund t`i tregosh fëmiut se çka mundet ai vetë të bëjë:

”Fëmiu im, nëse vëren apo përjeton bullizëm, thuaj atyre që bullizojn, se ti nuk pajtohesh me këtë. Mos heshtë, mos ikë apo mos u bë sikur se nuk po e vëren ngacmimin.

Nëse ajo çka ti iu thua nuk të ndihmon, tregoju njerëzve tjerë.

Tregoj mësuesit, drejtorit, shokëve tuaj apo neve prindërve në shtëpi.

Kërko nga prindërit, nga motra, vëllau apo nga shokët që të tregojnë, nëse ti vetë nuk mundesh apo nuk dëshiron të tregosh në shkollë.

Mësuesi apo ndonjë punëtor tjetër i shkollës i tregon drejtorit për këtë gjë.

Për bullizmin mund t`i tregohet mësuesit apo drejtorit poashtu duke ju dërguar mesazh në postë elektronike apo në Wilma.

Për bullizmin, diskriminimin dhe ngacmimin duhet me tregu qdoherë, edhe nëse një gjë e tillë nuk shkaktohet ndaj teje.

Është me rëndësi që të tregohet për bullizmin, pasi që viktima jo çdo herë tregon vet për këtë gjë.”

Burimi: Viikin normaalikoulu - Shkolla normale e Viikit | Yhdenvertaisuussuunnitelma - Plani për mosdiskriminim | www.helsinki.fi

Mënyra t`veprimit për ty si prind

- Së pari hulumtoje qështjen. Ndëgjoje fëmiun tënd, por megjithatë mos i beso fëmiut tënd automatikisht.
- Bisedo me fëmiun dhe me shkollën në mënyrë të qetë dhe arsyetoje pikëpamjen tënde.
- Shkolla mund të organizoj takim bisede me bullizuesin dhe me prindërit e tij.
- Shpesh herë situata mund të zgjidhet përmes bisedës dhe bullizmi përfundon aty.
- Kujdesu që besimi i ndërsjellt në mes teje dhe shkollës të qëndroj.
- Tregoj fëmiut tënd se ju si prind e mbështetni atë.

Këshillë!

Jasht shtëpie, fëmiu mund të gjej shokë e shoqe edhe nga grupi i ndonjë hobi.

Metoda të tjera: Burimi: Mannerheimin lastensuojeluliitto – Lidhja e Mannerheimit për mbrojtje të fëmijëve | www.mll.fi & <https://www.verywellfamily.com/ways-to-prevent-school-bullying-460755>

Si mundesh me ndërhy ndaj diskriminimit?

Mundesh me kontaktu Ombudspersonin për mosdiskriminim, nëse fëmiu yt është bullizuar në bazë të ngjyrës së lëkurës, fesë, gjuhës apo ndonjë vetie tjetër personale nga një nxënës, mësues apo dikush tjetër nga personeli I shkollës.

www.syrjinta.fi

Për krimet e shkaktuara nga dhuna duhet lajmëruar drejtpërdrejt policia.

Nëse fëmiut tënd I është shkaktuar dhunë, për shembull është goditur apo është shkëlmuar, tregoju drejtpërdrejt policisë. www.poliisi.fi



Centre for Economic Development,
Transport and the Environment



Monik ry
MEISTÄ ON MONIKSI!



Kuntoutussäätiö

Kymsote

MONIHELI

